



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery | 23.05.2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMSHUK | 4383 | 2023 | 1/4 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.557/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.557/2023 të datës 24.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Anullohet* Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për vitin 2022, i datës 31.01.2023, dhe *lënda kthehet në rivlerësim*.
- II. *Obligohet* Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Statistikave të Kosovës në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, më datë 24.03.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2022, të datës 31.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.03.2023 ka proceduar ankesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 07.04.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat ndërlidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokoll 4139/2023 të datës 05.05.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2964/2023 të datës 24.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 i datës 31.01.2023; Planin vjetor për kontratat e nënshkruar publikë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; Raporti për aktivitet e Prokurimit të realizuar deri më datë 31.12.2022; Raport mbi planifikimin përfundimtar të Prokurimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.03.2023, Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 3391/2023 e datës 07.04.2023; Emailin e datës 25.11.2022 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 12.05.2022, dhe 30.01.2023 nga _____ për ankuesin; Akt Emërimit e datës 29.03.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 31.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 30.12.2019; Emailin e datës 30.12.2019, 31.12.2019 nga _____ për ankuesin; Vendimin me numër protokoll 4139/2023 të datës 05.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të parashtruar nga palët në procedurë, konstatoi që lënda të kthehet në rishqyrtim, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi është e punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 29.03.2012, mban pozitën e punës *Shefi i Prokurimit*. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Statistikave të Kosovës në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt të ankuesit, me datë 31.01.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesi për vitin 2022, me notë të përgjithshme 1.5.

Ankuesi i pakënaqur me këtë vlerësim ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është tendencioz, jo real dhe jo objektiv për shkak se të gjitha detyrat e përcaktuara janë kryer sa i përket çështjes së prokurimit publik.

Kolegji në kuptim të vendosjes meritore ju referuar nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuara në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit.*



3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit... dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuara; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues...".*

Në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur së Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në cilësi të mbikëqyrësit, vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 e mbështet në sqarimin se: *realizimi i aktiviteteve të prokurimit është rreth 4.65%, pasi që planifikimi për vitin 2022 sipas planit të prokurimit ishte 2, 241. 116.00, ndërsa vlera prej 1, 028.800.00 nuk ka mundur të realizohet jo për fajin e zyrtarit të prokurimit, në shumë raste arsyetohet që nuk ka pranuar kërkesë ndërsa në raporte kolegjiale ka kërkuar nga njësitet ti shtyjnë kërkesat për shkak që është shumë i zënë. Shumicën e rasteve pagesat i ka kryer në ditën e fundit të afatit apo një ditë para fundit të afatit ligjor. Nuk ka bashkëpunuar me departamentet kërkuese në realizimin e planifikimit të mjeteve. Nuk ka raportuar në mujore, tremujore dhe gjashtë mujore ndërsa në baza javor ka qenë i rregullt, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegji mbikëqyrësi ka dhënë sqarim të përgjithshme, pa mbështetje në fakte dhe dëshmi që vërtetojnë këto pretendime.*

Po ashtu Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës nuk ka gjetur ndonjë plan individual të objektivave për ankuesin për vitin 2022 dhe po ashtu nuk vërtetohet fakti nëse mbikëqyrësi i ankuesit gjatë vitit 2022 ka mbajtur takime me ankuesin në kuptim të përmbushjes apo mos përmbushjes së objektivave si dhe takim lidhur me diskutimin e vlerësimit vjetor të rezultateve në punë siç përcaktohet me nenin 43 paragrafi 3,4, 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, nisur nga kjo gjendje e fakteve, Kolegji vendosi që çështja të kthehet në rishqyrtim me detyrimin që mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në rastin e ri vlerësimit të merr parasysh të gjeturat sipas këtij vendimi dhe se vlerësimi i objektivave të punës dhe sjelljeve profesionale të ankuesit të bazohet në objektivitet, dëshmi dhe bazë ligjore pse është i aplikueshëm.

Theksuar si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.557/2023

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

